

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Logjistika dhe Transporti
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III
Semestri:	VI
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	UShAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Konceptet themelore të menaxhimit të logjistikës dhe transportit, logjistika dhe transporti, zhvillimet e logjistikës dhe marrja e vendimeve në ndërmarrësi. Roli i qendrave logjistike dhe terminalit si mundësi ndërmarrëse. Qendrat e shpërndarjes së mallrave, zingjiret e furnizimit, organizimi dhe modelimi i transportit në logjistikë, si dhe teknologjia informative në logjistikë e cila ka një rëndësi të veçantë në ditët e sotme.,
Qëllimet e lëndës	Qëllimi kryesor i këtij moduli është të kuptuarit e parimeve kryesore, rëndësisë dhe zbatimit të menaxhimit të logjistikës dhe transportit në funksion të lehtësimit të bartjes së mallrave dhe komunikimit.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të suksesshëm të modulit, studenti duhet të: 1. Kuptoj konceptet themelore të logjistikës dhe transportit. (ECTS 0.5). 2. Njohe rolin dhe rëndësinë e zhvillimit të logjistikës në funksion të zhvillimit ekonomik. (ECTS 0.5). 3. Aplikoj njohuri baze për praktikën e marrjes së vendimeve në logjistikë të cilat do të zvogëlojnë koston e transportit. (ECTS 1). 4. Interpretoj kuptimin e qendrave të mëdha logjistike dhe terminalëve në funksion të transportit. (ECTS 1). 5. Identifikoj rolin dhe rëndësinë e teknologjisë informative në logjistikë e cila në ditët e sotme luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillim ekonomik dhe lehtësim të kryerjes së shërbimeve. (ECTS 0.5). 6. Demonstroni njohuri dhe kuptim të mundësive për të shfrytëzuar teknikat dhe parimet kryesore lidhur me organizimin e transportit të mallrave si dhe shfrytëzimin e teknologjisë informative në logjistikë., (ECTS 0.5).

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike	5	3	15
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet			
Përgatitja për detyra projekte			
Projekt kursi - Test (planifikim + zbatim)			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			30
Përgatitja përfundimtare në provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	2	6
Projektet, prezantimet etj	1	4	4
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, prezantimi në gupe nga studentet dhe zhvillimi i interaktiviteti, mësim praktikë për lenden dhe angazhim për studentin për të prezantuar njohurit e fituara gjatë ligjërës..		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	<u>Metoda e vlerësimit</u> – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 10 pikë (%), ➤ Prezantimi i projektit/punim seminari.....max 10 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 80 pikë (%), <u>Kriteret e kalueshmërisë:</u> 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: • Aktiviteti në mësim (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjërës. • Angazhimi (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantojë detyrat që caktohen në fund të secilës ligjërës dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjërës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo më shumë se 3 studentë) duhet të përgatitë një projekt/punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta. Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti –		

tema e propozuar nga studenti duhet te miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë ne korrelacion te plot me lëndën.
 Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit te projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	3
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	4
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	3
Gjithsej:	10

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - te ndërlidhura me mësim-nxënien ne moduln e lendes.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 80 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Studenti do t’i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuar nga senati i Universitetit.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet te plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....**40 pikë (%)**
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit.....**40 pikë (%)**

Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve te mësim-nxënies dhe aftësinë për t’i zbatuar ato në situata praktike.

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

Notat në UShAF:

Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm
8	C	70 - 79	Shumë mirë
7	D	60 - 69	Mirë
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm

Mjetet e konkretizimit Përdorimi i Smart-tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori,

– TI	PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	65% - Teori, 35% - Ushtrime praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulën e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studente, kuize studentore në klase, etj) Nga gjithsej 100 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 65% në fokus në teori dhe 35% në praktikë. • 65 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulën e lëndës. • 35 orë janë të fokusuar në ushtrime praktike, vizita pune, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 4 ECTS: ❖ 2.5 ECTS i dedikohen pjesës teorike ❖ 1.5 ECTS i dedikohen pjesës praktike. Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.
Literatura	
Literatura bazë	1. Ilir Doçi, Logjistika e transportit të mallrave, dispensë, Kolegji Tempulli, Prishtinë, 2008, 2. Gianpaolo Ghiani, Gilbert Laporte, Roberto Musmanno, 2013, Introduction to Logistics Systems Management, Willey,
Literatura shtesë	1. John Wiley & Sons Ltd, Introduction to Logistics Systems Planning and Control, 2004. 2. G. Don Taylor, Logistics Engineering Handbook, CRC Press, 2008 3. Andre Langevin, Diane Riopel, Logistics Systems - Design and Optimization, Springer, 2005, 4. Savo Vasiljevic, Logisticki Centri, Beograd, 2004
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Hyrje në sistemet logjistike
Java e dytë	Logjistika e transportit të mallrave, dispensë, R-1,
Java e tretë	Rolin dhe rendësin e zhvillimit të logjistikës në funksion të zhvillimit ekonomik, R-1,
Java e katërt	Marrja e vendimeve në logjistikë dhe mundësitë e zvogëlimit të Kostove, R-2,
Java e pestë	Kuptimin e qendrave të mëdha logjistike dhe terminaleve në funksion të transportit dhe ndërmarrjes. R-2, 3.
Java e gjashtë	Terminalet e mallrave dhe organizimi i vend qëndrimit të transportit

	te mallrave, R-3,
Java e shtatë	Qendrat e shpërndarjes se mallrave si mundësi e lehtësueses, R-3, 4,
Java e tetë	Zingjiret e furnizimit te mallrave, R-4,
Java e nëntë	Deponimi i mallrave, R-4,
Java e dhjetë	Logjistika e përgatitjes dhe paketimit te mallrave, R-4, 5,
Java e njëmbëdhjetë	Organizimi dhe modelimi I transportit, R-5,
Java e dymbëdhjetë	Teknologjia informative ne Logjistike, R-5,
Java e trembëdhjetë	Sistemi gjeografik I informimit, R-6,
Java e katëmbëdhjetë	Modelet e rrjetave të GIS dhe aplikimi në logjistikë, R-6,
Java e pesëmbëdhjetë	Përmbledhje e gjithë modulit
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësindhënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	